

Shoqata loi 1901, e themeluar më 1982, e njohur si me interes të përgjithshëm. Marrëveshje me HCR, anëtare e këshillit evropian për refugjatë dhe të ikur.

# Librezë për pranimin e kërkuesit të azilit duhet mbrojtur refugjatët

Forum réfugiés, tetor 2009  
me përkrahjen e Fondit Evropian për Refugjatë

**Kjo librezë i drejtohet personave që dëshirojnë të kërkojnë azilin politikë në Francë. Kjo librezë mundet të konsiderohet si një mjetë ndihmës dhe praktik për ti informuar personat në lidhje me procedurën e kërkesës për azil dhe ndihmat sociale që e shoqërojnë atë.**

Kjo librezë i drejtohet në veçanti të huajve që kanë hyrë në territorin e Francës në mënyrë të rregullt apo të parregullt. Kjo pra nuk i përket kërkesave të azilit që bëhen në kufi (zona e pritjes) ose në qendrat e mbajtjes administrative. Gjithashtu, situatat e veçanta si të miturit e vetmuar që kërkojnë azil, apo procedura e grupimit familjarë nuk trajtohen këtu. Megjithatë do të mund ti gjeni në faqen tonë të internetit [www.forumrefugies.org](http://www.forumrefugies.org)

Kjo librezë është ripunimi i botimit të dhjetorit 2006 duke i pasqyruar masat e ligjit të ri mbi azilin që ka hyrë në fuqi që atëherë.

Kjo librezë përbëhet nga tri pjesë : pjesa e parë e shpjegon procedurën e kërkesës për azil, pjesa e dytë i shpjegon ndihmat sociale (strehimin, shëndetin, ndihmat sociale) dhe pjesa e tretë përbën listën e adresave të organizmave dhe shoqatave që munden t'ju ofrojnë ndihmë gjatë kërkesën tuaj për azil.

Nëse dy pjesët e para zbatohen në tërë territorin francez, pjesa e tretë i përket më së shumti rrethit të Lyon-it.

Ne dëshirojmë që kjo librezë të jetë për ju që vini në Francë për të kërkuar mbrojtje një instrument i dobishëm. Ne i pranojmë me shumë vëmendje të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet tuaja të cilat do të na mundësojnë që ta përmirësojmë.

### **Jean Costil**

Kryetar i Forum réfugiés

### **Alain Couderc**

Avokat

Antar i Komisionit për të Drejtat e Njeriut pranë Dhomës të Avokatëve të Lyon-it  
Administrator i Forum réfugiés

### **Jean-François Ploquin**

Drejtor i Forum réfugiés

# Paralajmërim

Informatat që gjinden në këtë dokument në lidhje me procedurën e kërkesës për azil janë të inkuadruar nga tekstet kryesore në vazhdim :

## ■ Tekstet ndërkombëtare

- Konventa e Gjenevës të 28 korrikut 1951 në lidhje me statusin e refugjatëve;
- Protokollin i Nju Jorkut të 31 janarit 1967 në lidhje me statusin e refugjatëve;
- Protokollin i Nju Jorkut të 28 shtatorit 1954 në lidhje me statusin e shtetasve pa kombësi;
- Konventa për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut dhe të lirive themelore të 4 nëntorit 1950;
- Rregullorja Dablin II: Rregullorja e Këshillit të 18 shkurtit 2003 që ka përpiluar kriteret dhe mekanizmin për përcaktimin e Shtetit Antare e cila është përgjegjëse e një kërkesë të azilit e paraqitur në njërin prej Shteteve Antare nga një shtetas i huaj;
- Direktiva e kualifikimit: Direktiva 2004/83/CE e Këshillit të Bashkësisë Evropiane e 29 prillit 2004 në lidhje me normat minimale që kanë të bëjnë me kushtet që shtetasit e huaj apo shtetasit pa kombësi ligjore duhen ti plotësojnë për të pretenduar në statusin e refugjatëve apo personat që për arsye të tjera kanë nevojë për mbrojtjen ndërkombëtare dhe i përkasin këtyre statuseve;
- Direktiva e procedurës: Direktiva 2005/85/CE e Këshillit të Bashkësisë Evropiane e 1 dhjetorit 2005 në lidhje me normat minimale që kanë të bëjnë me procedurat e dhënies dhe të marrjes të statusit të refugjatit në Shtetet Anëtare;
- Direktiva e pritjes: Direktiva 2003/9/CE e Këshillit të Bashkësisë Evropiane e 27 janarit 2003 në lidhje me normat minimale për pranimin e kërkuësve të azilit në Shtetet Anëtare;

## ■ Tekstet franceze

- Kushtetuta e 4 tetorit 1958 (Hyrja e Kushtetutës me 27 tetor 1946).
- Kodi i Hyrjes dhe Qëndrimit të Huajve dhe të Drejtës për Azil (CESEDA)

---

Kjo librezë mundet të shqyrtohet në faqen tonë të internetit

**<http://www.forumrefugies.org>**

Kjo librezë është përgatitur nga punëtorët e Forum refugiés dhe mbështetet nga Fondi Evropian për Refugjatët.

Do të aktualizohet në bazë të zhvillimeve të rregulloreve.

**Riprodhimi i këtij dokumenti autorizohet me respektin e formës, shënimit e burimit dhe të gjitha përkrahjet.**

# Tabela *lëndëve*

## **1 — Format e ndryshme të mbrojtjes**

- 1.1. Statusi i refugjatit<sup>4</sup>
- 1.2. Mbrojtja e dorës së dytë (subsidaire)
- 1.3. Statusi i atyre që nuk kanë kombësi ligjore

## **2 — Pranimi në qëndrimin e përkohshëm : Prefektura**

- 2.1. Dokumentet që duhet paraqitur
- 2.2. Pranimi në qëndrim
- 2.3. Rastet që nuk pranohen për qëndrim

## **3 — Kërkesa e azilit : OFPRA dhe CNDA**

### **3.1. Zyra Franceze për Mbrojtje të Refugjatëve dhe personave pa kombësi ligjore (Office Français de Protection des Réfugiés et Apatrides) (OFPRA)**

- 3.1.1. Duhet ta plotësoni dosjen e OFPRA
- 3.1.2. Dokumentet që duhet ti paraqitni
- 3.1.3. Të dërgoni dosjen
- 3.1.4. Regjistrimi i kërkesës për azil
- 3.1.5. Récépissé
- 3.1.6. Takimi në OFPRA
- 3.1.7. Vendimi i OFPRA

### **3.2. Gjykata kombëtare për të drejtën e azilit (Cour nationale du droit d'asile) (CNDA)**

- 3.2.1. Afati i lutjes
- 3.2.2. Lutja
- 3.2.3. Vërtetimi i lutjes
- 3.2.4. Prania e Avokatit
- 3.2.5. Seanca në CNDA
- 3.2.6. Vendimi i CNDA
- 3.2.7. Fundi i procedurës të azilit

## **4 — Ndihmat sociale**

### **4.1. Strehimi**

- 4.1.1. Strehimi në qendrën për pranim
- 4.1.2. Strehimi urgjent
- 4.1.3. Strehime tjera

- 4.2. Ndhimë e përkohshme e pritjes
- 4.3. Sigurimi universal mjekësor
- 4.4. Ndhimja mjekësore e Shtetit
- 4.5. Të drejtat sociale të fëmijëve
  - 4.5.1. Ndhimat financiare për fëmijët dhe familjen
  - 4.5.2. Përkujdesi shëndetësor
  - 4.5.3. Shkollimi

## **5 — Të drejtat e personave të mbrojtura**

- 5.1. Mbrojtja në Francë
- 5.2. Qëndrimi në Francë
- 5.3. Integrimi në Francë
- 5.4. Udhëtimet jashtë vendit
- 5.5. Qëndrim dhe mbrojtje e familjes së ngushtë
- 5.6. Qasje në tregun e punës
- 5.7. Qasje në vendbanim
- 5.8. Shëndeti
- 5.9. Shërbime sociale dhe familjare
- 5.10. Natyralizimi

## **6 — Rishqyrtimi në OFPRA**

## **7 — Adresat e nevojshme**

- 7.1. Rrethi i Parisit
- 7.2. Rrethi i Lyon-it

## **8 — Lista e shteteve amë të sigurta**

# 1— Format e ndryshme të mbrojtjes

Në Francë ekzistojnë tri forma të mbrojtjes : statusi i refugjatit, mbrojtja e dorës së dytë (subsidaire) dhe statusi i atyre që nuk kanë kombësi ligjore.

## ● 1.1. Statusi i refugjatit

Mundet të ju njihet në bazë të tri themelimeve :

**Azili konvencional** : në zbatim të Konventës Ndërkombëtare të Gjenevës të 28 korrikut 1951 mbi refugjatët. Kjo konventë vlen për të « *gjithë personat që (...) frigohet me qenë të persekutuuar për arsye të racës, fesë, nënshitetësisë, përkatësisë në një grup social ose për mendime politike, dhe që gjendet jashtë ati shteti që e mbanë nënshitetësinë dhe që nuk mundet, për arsye të kësaj frike, dhe nuk do të kërkoj mbrojtjen e këtij shteti* ».

**Azili kushtetues** : në zbatim të hyrjes të Kushtetutës të 1946 që i përket « *çdo njeri i persekutuuar për arsye të veprimeve të tija në përkrahje të lirisë* ». Azili kushtetues i nënshtrohet rregullave të njëjta të procedurës dhe gjithashtu ofron të njëjtën mbrojtje posi azili konvencional, e vetmja gjë që ndryshon është baza juridike. Autoritetet përgjegjëse për shqyrtimin e kërkesës për azil janë po ashtu OFPRA dhe Gjykata kombëtare për të drejtën e azilit.

► **Procedura në lidhje me azilin konvencional vlen po ashtu edhe për azilin kushtetues.**

**Mandati i HCR (Komisariati i Lartë për Refugjatët)**: ju jeni njohur si refugjat nga Komisariati i Lartë për Refugjatë (UNHCR) në bazë të artikullit 6 dhe 7 të statusit të saj.

## ● 1.2. Mbrojtja e dorës së dytë (subsidaire)

Mbrojtja e dorës së dytë i njihet « *ati personit që nuk i përmbush kushtet për statusin e refugjatit (...) dhe që vërteton se në vendin e tij rrezikohet nga njëra prej këtyre rreziqeve të rënda* » :

a) dënimi me vdekje ;

b) torturë ose dënim apo keqtrajtim çnjerëzor apo poshtëruës ;

c) që i përket një civilit, një kërcënim i rëndë, i drejtpërdrejtë dhe individual kundër jetës së ti ose mbi personit e ti për arsye të dhunës së përgjithshme si pasojë e një konfliktit të armatosur të brendshëm apo ndërkombëtar ».

➤ Në Francë statusi i refugjatit dhe mbrojtja e dorës së dytë njihen nga ana e Zyrës Franceze për Mbrojtje të Refugjatëve dhe të Pa Kombëve (OFPRA) nën mbikëqyrjen e Gjykatës kombëtare pre të drejtën e azilit (CNDA).

➤ **Statusi i refugjatit dhe mbrojtja e dorës së dytë:** është fjala për procedurën e njëjtë gjatë së cilës kërkesa juaj për azil shqyrtohet **fillimisht** në kuadër të statusit të refugjatit dhe në rast refuzimi të të njëjtit në kuadër të mbrojtjes së dorës së dytë.

Me përfundim të shqyrtimit të kërkesës suaj për azil, OFPRA do të thotë nëse gjendja juaj do të jetë ajo e refugjatit, mbrojtjes së dorës së dytë apo e asnjërës nga këto forma të mbrojtjes. Në rast refuzimi, do të mund të bëni lutje pranë CNDA.

➤ OFPRA dhe CNDA mund t'ju refuzojnë statusin e refugjatit dhe mbrojtjes së dorës së dytë nëse vlerësojnë se keni qasje në mbrojtje në një pjesë të territorit të shtetit tuaj amë.

➤ Nuk do të mund të parashtroni kërkesë për azil në një shtet të vetëm të Bashkimit evropian sipas Rregullores së Dablinit.

### ● 1.3. Statusi i atyre që nuk kanë kombësi ligjore

Ky statut i kushtohet personit «*që asnjë Shtet nuk e konsideron si shtetas i tij në bazë të legjislacionit të këtij shteti*». Ky status ndryshon nga dy format e tjera të mbrojtjes dhe i përket vetëm personave që nuk kanë nënshtetësi. Ky statut nuk merr parasysh rreziqet për persekutim në vendin e origjinës.

Nuk keni nevojë të paraqiteni në prefekturë. Duhet të drejtoheni drejtpërsëdrejti në OFPRA duke dhënë emrin dhe adresën tuaj si dhe vullnetin për t'u njohur si person pa kombësi ligjore.

OFPRA ju dërgon formular për kërkesë të statusit të personit pa shtetësi ligjore.

Të njëjtin duhet ta mbushni dhe t'i shpjegoni rrethanat që ju shpjen deri te humbja e kombësisë ligjore.

Duhet të kthehet formulari përmes një letre të rekomanduar me vërtetimin për pranim.

Do të thirrreni nga OFPRA për bisedë.

■ **Nëse ju njiheni si njeri që nuk keni kombësi ligjore**, OFPRA do t'u japë një kartë për persona pa shtetësi ligjore. Prefektura do t'u japë juve po ashtu edhe bashkëshortes tuaj (nëse martesë është bërë para se të keni statusin e njeriut pa kombësi ligjore ose nëse martesë është bërë më së paku para një viti) dhe fëmijëve tuaj të mitur kur të mbushin moshën 18 vjeçare (16 vjet nëse dëshirojnë të punojnë), **një kartë qëndrimi të përkohshme me vërejtjen "jetë private dhe familjare"**. Kjo kartë qëndrimi, vlen 1 vit, ju autorizon të punoni. Ajo do të vazhdohet vetëm nëse gjithmonë i plotësoni kushtet që ju kanë mundësuar të keni këtë kartë herën e parë.

👉 Prefektura mund të refuzojë t'u japë kartë qëndrimi të përkohshme nëse prezenca juaj në territorin francez paraqet kërcënim për rendin publik.

■ **Nëse OFPRA refuzon kërkesën tuaj**, keni të drejtë të ankoheni për këtë vendim para Gjyqit Administrativ (TA) të vendit të qëndrimit tuaj në një afat prej 2 muajt duke nisur nga data e njoftimit për vendimin për refuzim.

👉 Nuk është paraparë dhënia e autorizimit të përkohshëm për qëndrim gjatë shqyrtimit të kërkesës së juaj për këtë statut. Mund të dërgoheni në shtetin tuaj gjatë procedurës. Nuk ekziston procedurë e përshpejtuar për të trajtuar kërkesën për status të personit pa kombësi ligjore. Mund të bëni kërkesën e këtij statusi në të njëjtën kohë kur të bëni kërkesën e azilit.

## 2— Pranimi në qëndrimin e përkohshëm : Prefektura

Për të bërë kërkesën e azilit, duhet së pari të kërkonti të drejtën për qëndrim në Prefekturën e qytetit ku qëndroni (në Prefekturën e Policisë nëse qëndroni në Paris). Ky veprim është i domosdoshëm për të gjithë personat që kanë më shumë se 18 vjet; ajo është fakultative për fëmijët që kanë më pak se 16 vjet. Ju duhet të paraqiteni në Prefekturë sa më shpejtë. Nëse keni hyrë në Francë me vizë, ju këshillojmë që të shkoni në Prefekturë për të kërkuar azil para se t'ju skadojë afati i vizës.

**► Ju mund të kërkonti azil edhe nëse keni hyrë në territorin francez në mënyrë jo të rregullt.**

Në disa rajone, janë prefekturat e regjioneve ato që prononcohen për pranimin e qëndrimit: është ky rasti me rajonet Akiten (Bordo), Overnj (Klermon-Feran), Normandi e Poshtme (Ken), Burgonj Dizhon), Bretanji (Ren), Qendër (Orlean), Shampanj-Arden (Shalon an Kampanj), Fransh-Komte (Bezanson), Normandi e Lartë (Ruen), Langedok- Rusijon (Montpelje), Limouzen (Limozh), Loren (Metz), Midi-Pirene (Tuluz dhe Montoban), Nord-Pad -Kale(Lil), Vendi i Luarës (Nant), Picardi (Bove), Puatu-Sharant (Puatje), Provans-Alp-Kot D'azyri (Marsej dhe Nic) dhe Ron-Alp (Lion dhe Grënobël)

### ● 2.1. Dokumentet që duhet paraqitur

Për t'ua pranuar qëndrimin si kërkues azili, duhet të paraqitni një numër të caktuar të dokumenteve lista e të cilëve do t'u jepet në prefekturë.

Është fjala për:

1. — 4 fotografi

2. — Të dhëna për gjendjen tuaj civile

**► Ju mund të kërkonti azil edhe në mungesë të pasaportës, vizës apo ndonjë dokument identifikimi; në këtë rast, ju duhet të bëni deklaratë me shkrim në lidhje me gjendjen tuaj civile.**

3. — Informata për rrethanat e hyrjes së juaj në Francë dhe itinerarin tuaj që nga nisja nga shteti juaj amë;

4. — Një vërtetim vendbanimi : prefektura ka nevojë të ketë një adresë ku do të mund t'ju dërgoj letrat në lidhje me kërkesën tuaj të azilit dhe të qëndrimit tuaj në Francë. Kjo adresë mundet të mos jetë vendi ku ju banoni. Nëse nuk keni vendbanim të caktuar, ju mundeni të deklaroni

adresën tuaj tek një person tjetër, me një hotel apo pranë një avokati. Ju mundeni gjithashtu të bëni një adresë vendbanimi pranë një shoqate e cila është e miratuar nga prefektura. Megjithatë, **pasi ti kaloj afati *récepissé* së parë tre mujorshe dhe për ta vazhduar atë, duhet të paraqitni një vërtetim të banimit**, do të thotë se duhet të paraqitni vërtetimin se ku jeni duke banuar me të vërtetë. Përndryshe, *récepissé*-ja juaj mundet të mos vazhdohet. Nëse nuk keni vendbanim të qëndrueshëm, do të mund të vazhdoni të paraqisni vendbanim të tjetër personi por me kusht.

**Si do qoftë, adresa që ju e jepni duhet të jetë brenda departamentit ku ju jepni kërkesën tuaj për azil.**

**Në çdo çast që procedura për azil është në vijim, me të ndërruar të adresës duhet ta informoni prefekturën.**

► **Prefektura nuk mund t'ju pyesë për arsyet e kërkesës tuaj për azil sepse këto i përkasin vetëm OFPRA e CNDA.**

## ● **2.2. Pranimi në qëndrim**

► **Prefektura do të merr gjurmët tuaja digjitale të gishtave për të vërtetuar nëse jeni paraqitur në ndonjë shtet tjetër evropian para se të vini në Francë.**

► **Prefektura ku paraqiteni mund t'ju pranojë qëndrimin në emër të një departamenti tjetër.**

**Nëse prefektura e pranon qëndrimin tuaj, ajo do t'ju pajis :**

- Me një *Autorisation Provisoire de Séjour (APS)* ose leje qëndrimi të përkohshme që vlen 1 muaj.  
Prej momentit që ju prezantoni të gjitha dokumentet e kërkuara nga prefektura, kjo e fundit ka 15 ditë afat për t'ju pajisur me APS;
- Me një formular për kërkesën e azilit që ju duhet ta mbushni dhe dërgoni në OFPRA **medoemos brenda 21 ditëve.**

📁 **Dosja juaj e kompletuar duhet të dërgohet në OFPRA brenda afatit 21 ditor. Nëse dosja juaj arrin pas këtij afati, kërkesa juaj për azil nuk do të regjistrohet dhe OFPRA do ta kthej prapa. Në këtë rast, ju mundi të humbni të drejtën të kërkonti azilin. Afati 21 ditor vlen nga data e cila është e shkruar në APS tuaj.**

✎ Nëse OFPRA nuk e regjistron kërkesën tuaj për azil, do t'u duhet të prezantoni në kërkesë të re për pranimit të qëndrimit në emër të azilit pranë prefekturës duke cekur shkaqet që ju parandaluan të dërgoni dosjen në afatin e caktuar. Një lutje mund gjithashtu të parashtrohet pranë OFPRA.

Në këto ndërmarrje, është e pëlqyeshme të shoqëroheni nga një shoqatë.

## ● 2.3. Rastet që nuk pranohen për qëndrim

Në pajtim me artikullin L741-4 të CESEDA, **prefektura mund të refuzojë që t'ju pajis me APS në katër raste :**

■ **Ju i nënshtroheni Rregullores së Dablini:** Një shtet tjetër evropian duhet ta shqyrtojë kërkesën tuaj për azil: nëse keni kaluar përmes një shteti evropian që e ka nënshkruar **Rregulloren e Dablini** (Gjermania, Austria, Belgjika, Qipra, Danimarka, Spanja, Estonia, Filanda, Britania e Madhe, Hungaria, Greqija, Irlanda, Italia, Letonia, Lituania, Luxemburgu, Malta, Republika Çeke, Holanda, Polonia, Portugalia, Sllovakia, Sllovenia, Suedia dhe Zvicra që nga dhjetori 2008) ose nëse autoritetet e ndonjërit prej këtyre shteteve ju kanë dhënë vizë.

Prefektura do të nis procedurën për ti kërkuar këtij shteti që t'u marrë në shtetin e vet; ajo do t'ju pajis me një dokument që ju lejon të qëndroni në Francë deri sa të merrni përgjigjen e këtij shteti.

Nëse shteti pranon t'u merr, prefektura mundet të vendosë t'u shoqërojë me polici deri në këtë shtet dhe t'u vendosë në qendrën e mbajtjes administrative në pritje të largimit.

Nëse shteti në fjalë refuzon t'u merr, do të pranoheni në Francë dhe do të keni mundësi të bëni kërkesën për azil e cila do të shqyrtohet sipas procedurës normale.

■ **Shteti juaj amë është i klasifikuar në listën e shteteve të sigurta.** Ju keni nënshtetësinë e një shteti për të cilin OFPRA vlerëson që në mënyrë të përgjithshme nuk ka më rreziqe të persekutimit. Apo keni nënshtetësinë e një **shteti amë të konsideruar si "i sigurt"** nga Këshilli administrativ i OFPRA. Shtetet që gjenden në këtë listë në qershor 2005 e më pas maj 2006 janë : Benini, Bosnjë Hercegovina, , Kap Verde, Kroacia, Gjeorgjia, Gana, India, Maqedonia, Madagaskari, Mali, Mauritius,

Monogolia, Senegali, Tanzania dhe Ukraina.

👉 Prapë se prapë, ju keni mundësi të parashtroni kërkesën tuaj në OFPRA me ndërmjetësimin e prefekturës që ju jep një formular për kërkesë azili. Kjo kërkesë do të shqyrtohet në përparësi. Ju keni në dispozicion afat prej 15 ditësh për ti dorëzuar prefekturës, në zarf të mbyllur, kërkesën tuaj të plotësuar dhe nënshkruar. Prefektura nuk duhet t'i njuh elementet tuaj për kërkesë azili që janë të besueshme. Me pranimin e dosjes për azil, prefektura ia dorëzon OFPRA duke cekur se ka karakter prioritar. Kërkesa juaj për azil do të shqyrtohet në procedurë prioritare. OFPRA do t'u përgjigjet brenda 15 ditëve. Nëse përgjigjja është negative, ju mundeni të bëni lutje pranë Gjykatës kombëtare për të drejtën e azilit, por kjo lutje nuk e asgjëson masën e dëbimit në shtetin tuaj amë që mund të merret nga prefektura.

■ **Nëse prania juaj në shtetin Francezë paraqet një kërcënim të rëndë për rendin** dhe sigurinë publike apo për sigurimin e Shtetit. E njëjta procedurë si në rastin paraprakdo të zbatohet.

■ **Kërkesa juaj konsiderohet se është bërë me qëllime mashtruese** nëse (për shembull ju keni bërë disa kërkesa për azil me emra të ndryshëm) apo keqpërdorim (nëse ju e kërkonti azilin gjatë vendimit për t'ju larguar nga Franca apo gjatë një arrestimit duke e ditur se jeni në Francë prej një kohe). E njëjta procedurë si në rastet e më parshëm do të zbatohet.

# 3— Kërkesa e azilit : OFPRA dhe CNDA

Prefektura sapo u ka pajisur me formularin e kërkesës për azil

## ● 3.1. Zyra Franceze për Mbrojtjen e Refugjatëve dhe Personave pa Kombësi Ligjore (Office Français de Protection des Réfugiés et Apatrides) (OFPRA)

### 3.1.1. Duhet të plotësoni dosjen e OFPRA

- Dosja duhet të shkruhet patjetër në gjuhën frënge;
- Duhet të shkruani adresën tuaj në mënyrë shumë të lexueshme;
- Duhet të plotësoni me saktësi të gjitha rubrikat që kanë të bëjnë me gjendjen tuaj personale dhe familjare;
- Duhet të jeni të kujdesshëm për atë se cilën(at) gjuhë e deklaroni se e flisni. Duhet të ceken gjuhët që i flisni rrjedhshëm meqë mund të njëjtat të përdoren gjatë intervistës;
- Rubrika n°15 e dosjes të OFPRA-ës është e rezervuar vetëm për arsyet që ju e kërkonti azilin. Duhet të shkruani një histori të jetës tuaj personale duke i precizuar datat, vendet dhe arsyet që juve ju kanë shtyre ta lëshoni vendin tuaj dhe arsyet për të cilat ju nuk mundeni të ktheheni në vendin tuaj. Është shumë me rëndësi që ju ti kërkonti OFPRA-ës që t'ju thërras në takim.

**► Mos harroni ta nënshkruani dosjen dhe të vëni datën sepse në mungesë të tyre, OFPRA nuk do të mund ta regjistrojë kërkesën tuaj (për të miturit duhet përfaqësuesi i tij ligjor ta nënshkruaj).**

### 3.1.2. Dokumentet që duhet ti paraqitni

**Duhet detyrimisht të paraqitni:**

- Një fotokopje të lejeqëndrimit tuaj të vlefshëm (APS).
- 2 fotografi identifikimi.
- Dokumentet origjinal apo dokumentet e udhëtimit që keni me vete (pasaportën, letërnjoftimin, leje-qarkullimin, certifikatën e lindjes ...).

**► Ju duhet ta mbushni rubrikën numër 5 të formularit të OFPRA i cili i përket dokumenteve të identifikimit (ose mungesës së dokumenteve) që duhet t'ia bashkëngjitni dosjes suaj nëse i keni me vete.**

- Dokumentet që munden ta mbështesin kërkesën tuaj dhe që i keni me vete. Nuk ka nevojë që t'i dorëzoni edhe përkthimet e këtyre dokumenteve.

➤ Para se të dërgoni dosjen tuaj në OFPRA (apo ta keni sjellë në prefekturë nëse jeni vendosur në procedurë urgjente), është e rëndësishme të verifikoni nëse dosja është mbushur mirë sipas udhëzimeve dhe që të gjitha gjërat e kërkuara i keni bashkëngjitur me dosjen tuaj. Nëse dosja juaj nuk është complete, OFPRA do ta kthejë mbrapa me postë. **Kërkesa juaj e azilit nuk do të regjistrohet deri sa dosja juaj të mos jetë e plotësuar mirë.** Dosja juaj e kompletuar të mund të tejkalojë afatin 21 ditor dhe në këtë rast, OFPRA do t'jua kthej mbrapa dosjen. Ju rrezikoni që të mos keni më mundësi të kërkonit azil.

➤ Nëse OFPRA nuk e regjistron kërkesën tuaj për azil, do të duhet të parashtroni kërkesë të re për pranim administrativ të qëndrimit në titull të azilit pranë prefekturës duke i cekur shkaqet që ju kanë pamundësuar dërgimin e dosjes në afatin e caktuar. Një lutje gjithashtu mund të parashtrohet pranë OFPRA-së;

**Në këto ndërmarrje është e pëlqyeshme të shoqëroheni nga një shoqatë.**

### **3.1.3. Dërgoni dosjen**

Nëse jeni pranuar për qëndrim. **Është e domosdoshme të dërgoni dosjen tuaj deri tek OFPRA brenda afatit 21 ditor prej ditës kur ju e keni marrë APS-në tuaj.** Nëse e dërgoni dosjen tuaj me postë, ne ju këshillojmë që ju ta dërgoni me « recommandé avec accusé de réception » (e rekomanduar me vërtetim dërgimi) duke e shkruar në mënyrë të lexueshme emrin dhe mbiemrin tuaj në pjesën « expéditeur » (dërguesi). Nëse e keni adresën tek një shoqatë apo tek një person tjetër, mos harroni të shkruani emrin e tyre në adresën tuaj.

Ruani mirë provat e dërgimit me postë të dosjes. Ju mundeni ta dorëzoni dosjen tuaj drejtpërdrejtë në zyrat e OFPRA-ës.

Ruani mirë fotokopjet e tërë dosjes që e dërgoni në OFPRA (edhe formularin e OFPRA-ës) dhe të të gjitha dokumenteve që i dërgoni me

dosjen tuaj në OFPRA.

**▶ Gjatë gjithë procedurës sa do të zgjasë shqyrtimi i kërkesës tuaj, pos në rast se OFPRA e ka marrë vendimin e saj për kërkesën tuaj, mundeni të dërgoni elemente të reja plotësuese për dosjen tuaj. Mos harroni të shkruani numrin e dosjes tuaj në çdo letër që e dërgoni në OFPRA. Ky numër i dosjes gjendet në letrën « d'enregistrement d'une demande d'asile » (regjistrimi i kërkesës për azil).**

### **3.1.4. Regjistrimi i kërkesës për azil**

Nëse kërkesa juaj është complete, OFPRA do t'ju dërgoj një letër që quhet « d'enregistrement d'une demande d'asile » (regjistrimi i kërkesës për azil) në adresën që ju e keni paraqitur në dosjen tuaj. Ky dokument e vërteton se kërkesa juaj e azilit është regjistruar në mënyrë zyrtare.

**Kujdes, ruani mirë këtë dokument meqë nuk do t'u dërgohet duplikat i tij nëse kërkonti.**

### **3.1.5. Récépissé**

Nëse keni APS, posa t'u vijë letra e regjistrimit të kërkesës tuaj për azil, e cila duhet të ju vi para se t'i skadojë afati APS një mujore, duhet të paraqiteni në prefekturë me këtë letër dhe me një adresë të re. Brenda tri ditësh, prefektura do t'ju pajis me një « récépissé që e konstaton kërkesën e azilit ». Kjo récépissé vlen tre muaj, e mandej do të vazhdohet deri sa të kryhet procedura. Çdo herë që do të shkoni për ta vazhduar récépissé-në, duhet të paraqitni një vërtetim të vendbanimit. Në rast se nuk e paraqitni vërtetimin e vendbanimit, ka mundësi që récépissé-ja juaj të mos vazhdohet. Megjithatë, nëse nuk keni vendbanim të qëndrueshëm, do të mund të vazhdoni të paraqisni vendbanim të tjetrit por me kusht.

**Me këtë récépissé nuk ju lejohet të punoni.**

### **3.1.6. Takimi në OFPRA**

OFPRA ka për obligim t'ju thërras në takim. Por mundet që t'ju kthej përgjigje pa ju thirrur fare. Kjo është e mundur në katër raste :

■ Elementet që ju i keni paraqitur në dosjen e kërkesës për azil janë të mjaftueshme për OFPRA-ën që ajo të marrë një vendim pozitiv.

■ Ju e keni nënshtetësinë e një shteti për të cilën OFPRA ka vlerësuar që në mënyrë të përgjithshme nuk ka më rrezik për persekutime.

■ Elementet që ju i keni paraqitur në kërkesën tuaj për azil tregohen si të pabaza dhe nuk janë në pajtim me tekstet e rregulloreve që parashohin mbrojtjen e një njeriu apo motivet për kërkesën tuaj nuk janë mjaftueshëm mirë të shpalosur. Për arsye mjekësore, ju nuk mundeni të shkoni në takim.

■ Nëse për shkaqe shëndeti nuk jeni në gjendje të zhvilloni intervistën. Në këtë rast, OFPRA do të marrë vendimin pa ju marrë në pyetje.

Nëse OFPRA ju thërret në takim, ju do të merreni në pyetje nga një Zyrtarë i mbrojtjes. OFPRA do të sjellë një përkthyes në gjuhën që ju e keni deklaruar se e flitni në dosjen e kërkesës për azil.

▶ ***Nëse ju nuk paraqiteni në këtë takim, kjo do të ketë pasoja negative për kërkesën tuaj.***

▶ ***Në rast se ju e ndërroni adresën, duhet sa më shpejtë të lajmëroni OFPRA-ën me postë në afat sa më të shkurtër dhe mundësisht me letër «recommandé avec accusé de réception». Këtë duhet ta bëni për arsye se OFPRA do t'ju dërgoj përgjigjen e saj në adresën e fundit që ju ja keni dhënë.***

***Ruani një kopje të letrës që ju e keni lajmëruar për ndryshimin e adresës dhe ruani gjithashtu provat që e keni dërguar atë letër me postë.***

### **3.1.7. Vendimi i OFPRA-ës**

Kohëzgjatja e afatit për përgjigjen e OFPRA-ës është e ndryshme. Mundet të zgjasë shumë kohë por edhe ta merrni shumë shpejtë. Duhet të jeni të kujdesshëm dhe të verifikoni shpesh letrat që ju arrin.

Vendimi i OFPRA-ës paraqitet në tri forma :

- Ju pranoheni si refugjat (ju pranohet statusi i refugjatit).
- Ju e fitoni mbrojtjen e dorës së dytë apo subsidiaire (statusi i refugjatit është hedhur poshtë dhe ju është pranuar mbrojtja e dorës së dytë).
- Kërkesa tuaj për azil është hedhur poshtë (statusi i refugjatit dhe mbrojtja e dorës së dytë janë hedhur poshtë).

■ **Nëse ju njiheni si refugjat,** OFPRA ju dërgon një letër me vendimin e pranimit për statut të refugjatit. Me prezantimin e këtij dokumenti, brenda 8 ditëve ajo do t'ju pajis me një récépissé për kërkesën e kartës që quhet karta e banuesit dhe që vlen 3 muaj. Kjo kartë

ju jep të drejtë të punoni dhe të keni mbas afatit tre mujor **kartën e banorit për 10 vite e cila do të vazhdohet me të gjitha të drejtat**. Kjo do të vlejë edhe për bashkëshorten tuaj (nëse martesë është bërë para se të keni statusin e refugjatit ose nëse është bërë më së paku para një viti ose nëse edhe bashkëshortja juaj e ka marrë statusin e refugjatit) dhe për fëmijët tuaj të mitur kur ti mbushin moshën 18 vjet (apo 16 nëse dëshirojnë të punojnë). Me kërkesën tuaj, prefektura mundet të ju pajis me një dokument udhëtimi i cili do t'ju mundësoj të udhëtoni në çdo vend përveç vendit që ju e keni nënshtetësinë. OFPRA bëhet në këtë rast e vetmja administratë që mundet t'ju jep certifikatat e gjendjes civile e që nuk mundeni ta merrni më në vendin tuaj.

► **Nëse ju ktheheni në vendin tuaj apo hyni në kontakt me autoritetet diplomatike apo konzullare të vendit tuaj, ekspononi veten në mundësinë e humbjes të statusit të refugjatit.**

✚ **Prefektura mund të refuzojë t'ua jep kartën e banorit nëse prezenca juaj në territorin francez paraqet një kërcënim për rendin publik.**

*Shih rubrikën 5 të kësaj libreze për të drejtat e personave të mbrojtur.*

✚ **Nëse ju njihet mbrojtja e dorës së dytë apo subsidiaire**, OFPRA ju dërgon një letër me të cilën ajo e vërteton se ju mbroheni nga kjo mbrojtje. Me paraqitjen e kësaj letrë, prefektura do t'ju pajis me një *récépissé* për kërkesën e kartës që quhet karta e banuesit dhe që vlen 3 muaj, me të të drejtë të punoni në pritje të kartës së ashtuquajtur **carte de séjour temporaire me shënimin « jetë private dhe familjare » që do të vlejë 1 vit**. Kjo do të vlejë edhe për bashkëshorten tuaj (nëse martesë është bërë para se të keni statusin e mbrojtjes së dorës së dytë ose nëse është bërë më së paku para 1 viti) dhe për fëmijët tuaj të mitur kur ti mbushin moshën 18 vjet (apo 16 nëse dëshirojnë të punojnë). Kjo kartë e qëndrimit ju jep të drejtë të punoni dhe vazhdohet nëse shkaqet që ju kanë mundësuar të keni këtë mbrojtje ekzistojnë ende.

Nëse OFPRA vlerëson se nuk mund më t'u drejtoheni zyrtarëve të shtetit tuaj amë për të marrë pasaportë, me kërkesën tuaj prefektura do t'u lëshojë një dokument udhëtimi që do t'ju mundësojë të shkoni në të gjitha shtetet pos shtetit tuaj amë. Në këtë rast OFPRA bëhet gjithashtu administrata që i lëshon aktet e gjendjes civile të cilat nuk mund më ti merrni pranë zyrtarëve të shtetit tuaj amë.

Në rastin e kundërt, duhet të vazhdoni t'u drejtoheni autoriteteve tuaja.

👉 Prefektura mund të refuzojë t'u jep kartën e përkohshme për banues nëse prezenca juaj në territorin francez paraqet kërcënim për rendin publik.

*Shih rubrikën 5 të kësaj libeze për të drejtat e personave të mbrojtur.*

■ **Nëse OFPRA ju dërgon përgjigje negative në lidhje me kërkesën tuaj të azilit** (statusi i refugjatit dhe/apo mbrojtja e dorës së dyte apo subsidiaire), ju keni të drejtë të kundërshtoni këtë vendim dhe të bëni lutje para Gjykatës kombëtare për të drejtën e azilit brenda afatit një mujor.

OFPRA do t'ia bashkëngjet vendimit të saj për refuzim edhe kopjen e shënimeve të mara nga ana e zyrtarit për mbrojtje gjatë intervistës.

👉 **Nëse nuk u është pranuar qëndrimi nga ana e prefekturës dhe jeni vendosur në procedurë prioritare, keni të drejtë të qëndroni në Francë vetëm deri në njoftimin e vendimit që ka marrë OFPRA.** Edhe nëse bëni lutje pranë CNDA-së, prefektura mban të drejtën t'u japë vendim dëbimi nga territori (Detyrim për të lëshuar territorin francez (OQTF) apo Vendim të prefekturës për eskortim deri në kufi (APRF)).

▶ **Nëse nuk bëni lutje pranë Gjykatës kombëtare për të drejtën e azilit (CNDA), ekspozoni veten në refuzimin e qëndrimit. Prefektura mund t'u njoftojë për Detyrimin për të lëshuar territorin francez (OQTF) brenda afatit një mujor.**

## ● **3.2. Cour nationale du droit de l'asile (CNDA)**

Vendimi negativ i OFPRA-ës ju dërgohet me letër « recommandé avec accusé de réception » në adresën e fundit që ju e keni dhënë në OFPRA. Asaj i bashkëngjiten edhe shënimet nga intervista.

### **3.2.1. Afati i lutjes**

Keni **afat një muaj prej momentit që ju është njoftuar vendimi negativ** i OFPRA-ës për të regjistruar lutjen tuaj pranë CNDA (për shembull : nëse ju e merrni letrën në postë me 20 janar, lutja juaj pranë CNDA duhet të regjistrohet para datës 21 shkurt). Pra, ju duhet ta dërgoni lutjen tuaj disa ditë më parë para se ti skadojë afati.

**Nëse afati një mujor është tejkualuar, lutja juaj nuk do të**

**pranohet dhe kjo do të thotë se kërkesa juaj do të hidhet poshtë pa u shqyrtuar.**

✎ Nëse nuk gjendeni në shtëpi kur t'ju arrin letra nga OFPRA apo nëse e keni adresën tek ndonjë shoqatë, posta do të le një letër për t'ju informuar se një letër ju ka ardhur në poste. Posta do ta ruaj letrën tuaj 15 ditë. Nëse nuk shkoni të kërkonit letrën në postë për 15 ditë, posta do ta kthejë në OFPRA. Në këtë rast, afati një mujor për lutje fillon prej datës kur postieri e ka lënë letrën që ju ka njoftuar se një letër ju ka ardhur në postë.

### **3.2.2. Lutja**

- Lutja duhet të shkruhet në gjuhën frënge, në një letër të pastër (sepse nuk ka formular specifik për të) dhe në të cilën duhet ti cekni emrin, mbiemrin, gjendjen tuaj civile, profesionin dhe adresën.
- Duhet patjetër të dërgoni bashkë me lutjen edhe vendimin e OFPRA-ës origjinalin apo fotokopjen e këtij vendimit.
- Duhet të tregoni pse nuk i pranoni arsyet e hedhjes poshtë të kërkesës tuaj nga OFPRA. Shpjegoni shkaqet që ju bënë të ikni nga shteti juaj dhe çka ju parandalon të ktheheni në vendin tuaj. Nëse OFPRA nuk ju ka thirrur në takim, është mirë që ta cekni këtë në lutjen tuaj. Duhet që lutja juaj të ngrihet mjaftueshëm sa për tu mos llogaritur si e pabazë. Në këtë rast, CNDA do të mund që në fillim të refuzojë lutjen tuaj, që do të thotë pa intervistë.
- Duhet ti dërgoni dokumentet që e vërtetojnë identitetin tuaj, nënshtetësinë tuaj dhe historinë tuaj. Është e pëlqyeshme të bashkëngjitni një kopje të dokumenteve dhe ti paraqitni origjinalet ditën e intervistës në CNDA.  
Këto dokumente duhen të jenë të përkthyer në gjuhën frënge.  
Në mungesë të përkthimeve, CNDA nuk do të mund ti përdorë ato dokumente. Nuk është e domosdoshme që përkthimi të jetë bërë nga ana e një përkthyesi të autorizuar.
- Duhet nënshkruar lutjen tuaj. Nëse jeni i mitur, njëri prej prindërve apo përfaqësues ligjor duhet ta nënshkruaj dosjen e lutjes.
- Është e domosdoshme që dosjen tuaj të lutjes ta dërgoni me letër «recommandé avec accusé de réception».

✎ Ruani me kujdes dëshmitë e dërgimit dhe lënies së dërgesës suaj në postë.

✎ Ruani fotokopjet e tërësisë së lutjes suaj.

✎ Njoftoni CNDA-në për çdo ndryshimi të adresës duke cekur numrin e dosjes suaj (shih më poshtë)

➤ Nuk mund të sillni informata shtesë CNDA-së tre ditë para fillimit të intervistës.

### 3.2.3. Vërtetimi i lutjes

Pasi të dërgoni lutjen, CNDA do t'ju dërgojë në adresën që e keni paraqitur një dokument të quajtur « *accusé de réception du recours* ». Ky dokument do të vërtetoj që lutja juaj është regjistruar. Këtë dokument duhet ta paraqitni në prefekturë për vazhdimin e *récépissé* për 3 muaj. Pasi të merrni këtë dokument, nuk duhet të harroni se në çdo letër që do të dërgoni në CNDA, duhet cekur numrin tuaj të regjistrimit që gjendet në vërtetimin e lutjes « *accusé de réception de votre recours* ».

Gjatë kësaj dërgese CNDA ju dërgon një dokument që kërkon të cekni gjuhët që deklaroni se i flisni për shkak të seancës.

► ***Nëse *récépissé* juaj gati ka skaduar dhe ju nuk keni pranuar vërtetimin e lutjes « *accusé de réception de votre recours* », këshillohet që të ruani vërtetimin e postës për dërgesë "accusé de réception de la poste" si dëshmi.***

### 3.2.4. Prania e Avokatit

Keni mundësi të keni një avokat gjatë seancës tuaj në CNDA. Mund të jetë vetëm avokat që ju keni zgjedhur dhe të cilit ju pranoni t'ia paguani honoraret apo të një avokati që paguhet nga në emër të ndihmës juridike.

Në fakt mund të kërkonte një avokat në emër të ndihmës juridike, atëherë ai paguhet nga shteti plotësisht ose pjesërisht. Për këtë duhet të drejtoheni deri te zyra **Bureau d'Aide Juridictionnelle (BAJ) të CNDA**. Këtë avokat mundeni ju lirisht ta zgjidhni apo t'u caktohet nga BAJ. Me fillim në 1 dhjetor 2008, nuk ka nevojë të dëshmoni se keni hyrë në Francë në mënyrë të rregullt (viza, pos lejes së dhënë në zonë të pritjes, etj).

- Burimet tuaja nuk kalojnë një plafon të caktuar;
- Lutja juaj nuk duket si qartazi e pa pranueshme apo e pa bazë

**Për më tepër informata për sa u përket afateve, këshillohet të konsultoheni me ndonjë shoqatë.**

### 3.2.5. Seanca në CNDA

Nëse Gjykata kombëtare për të drejtën e azilit vlerëson lutjen tuaj si të pranueshme, ajo do t'u thërret në seancë. Kjo thirrje ju dërgohet me postë parimisht një muaj para datës së seancës.

Në seancë, trupi gjykues i CNDA që do ta shqyrtoj lutjen tuaj përbëhet nga 3 persona : një Kryetar (gjykatës), një person i kualifikuar i emëruar nga Komisariati i Lartë për Refugjatë (HCR) dhe një person i kualifikuar dhe i emëruar nga Nën-Kryetari i Këshillit të Shtetit. Trupi gjykues i CNDA-së do të prononcohet lidhur me lutjen tuaj pasi të ketë dëgjuar sintezën e raportuesit lidhur me kërkesën tuaj për azil dhe do të propozojë zgjidhje, pasi të ketë dëgjuar mbrojtjen e avokatit tuaj, nëse do të keni një të tillë, dhe pasi t'u ketë parashtruar pyetje.

CNDA do të siguroj prezencën e përkthyesit në gjuhën që ju e keni caktuar në formularin e OFPRA-ës apo në dokumentin që CNDA-ja ua ka adresuar në të njëjtën kohë me vërtetimin për lutje "reçu de recours". Prezenca juaj në këtë seancë është shumë me rëndësi dhe në ju këshillojmë të shkoni. Kjo seancë është publike por ju mund të kërkonti të mbahet me dyer të mbyllura, do të thotë të shqyrtohet pa publik.

**► Por, duhet përkujtuar se CNDA mundet të shqyrtoj lutjen tuaj dhe të marrë vendimin për ta hedhur poshtë atë pa ju thirrur në seancë, nëse lutja juaj nuk paraqet elemente serioze që do ta vinin në pyetje vendimin e OFPRA-ës.**

### **3.2.6. Vendimi i CNDA**

Në parim, në afat prej 3 javësh pas seancës, CNDA e publikon vendimin e marrë (anulim/refuzim) në lokalet e saja dhe ju dërgon vendimin e saj me letër recommandé me vërtetim pranimi. Ndaj mund që:

■ **CNDA e anulon vendimin e OFPRA-ës dhe ju njeh statusin e refugjatit.** Kjo do të thotë se ju do ti keni të njëjtat të drejta posikur të kishit marrë statusin e refugjatit nga OFPRA ;

*Shih rubrikën 5 të kësaj libeze për të drejtat e personave të mbrojtur.*

■ **CNDA e anulon vendimin e OFPRA-ës dhe ju njeh mbrojtjen e dorës së dytë apo subsidiaire.** Kjo do të thotë se ju do ti keni të njëjtat të drejta posikur të kishit marrë mbrojtjen e dorës së dytë nga OFPRA ;

*Shih rubrikën 5 të kësaj libeze për të drejtat e personave të mbrojtur.*

■ **CNDA e pranon vendimin e OFPRA-ës.** Kjo do të thotë se edhe CNDA e hedh poshtë kërkesën tuaj për azil (statusin e refugjatit dhe mbrojtjen e dorës së dytë).

### **3.2.7. Fundi i procedurës për azil**

Kundër vendimit negativ të CNDA ju mundeni të bëni lutje të fundit pranë Këshillit të Shtetit në afat prej 2 muajsh. Megjithatë, Këshilli i Shtetit nuk do ta shqyrtoj tërësisht kërkesën tuaj por vetëm disa pyetje juridike.

Kjo është procedurë e gjatë dhe shumë e shtrenjtë dhe keni nevojë për

avokat të specializuar (ju mund të kërkonti ndihmën juridike).

Kjo procedurë nuk do të lejojë zgjatjen e lejes suaj të përkohshme për qëndrim dhe nuk do ta ndaloj shtetin kthimin në vendin tuaj amë.

Merrni këshilla pranë një shoqate apo avokati.

Vendimi i CNDA mund gjithashtu të jetë bazë për një prolongim për 2 muaj të një lutjeje në korrigjim gabimi material para CNDA-së vetë dhe nëse dhe vetëm nëse vendimi përmban një gabim material që del nga CNDA dhe që ka gjasa të ketë ndikim mbi vendimin e marrë. Merrni këshilla nga një shoqatë a avokat.

✎ **Mospranimi i kërkesës tuaj për azil nga CNDA do të thotë se récépissë-ja juaj për tre muaj nuk do të vazhdohet më dhe nuk vlen më.**

Prefektura do t'ju dërgoj një dokument që do t'ju lajmëroj se qëndrimi juaj këtu ka marrë fund dhe që duhet ta lëshoni Francën brenda një muaji (është fjala për OQTF).

Brenda afatit njëmuajor mundeni të kundërshtoni vendimin për të lëshuar territorin . Gjithashtu mund të gëzoni të drejtën e **ndihmës për kthim vullnetar** në shtetin tuaj amë.

Duhet atëherë të merrni kontakt me Delegacionin e Zyrës franceze për imigrim dhe integrim (OFII, më parë ANAEM).

Kjo ndihmë për kthim vullnetar përbën një ndihmë materiale dhe administrative për të përgatitur nisjen ( pagesa e udhëtimit, marrja e dokumenteve të nevojshme në vend, mbyllja e llogarive bankare, etj); një ndihmë financiare të lëshuar në tre këste (2000 € për të rritur, 3500 € për çift të martuar, dhe 1000 € për fëmijë të mitur deri herën e 3-të dhe 500 € pas herës së tretë); si dhe një ndihmë për riintegrim në shtetin amë.

Nëse në fund të muajit të OQTF-së, nuk e keni lëshuar territorin apo kërkuar ndihmë për kthim vullnetar dhe gjendeni akoma në Francë, atëherë jeni në gjendje të jo të rregullt për sa i përket qëndrimit dhe prefektura, do të mund të aktivizojë zbatimin e masës dëbim për ju. Kjo masë mund të shoqërohet nga vendosja në qendër qëndrimi para se të vazhdohet me kthimin tuaj në shtetin amë.

✎ **Detyrimi për të lëshuar territorin francez (OQTF) mund të kundërshtohet në afat prej një muaji përpara Gjykatës administrative. Gjykata administrative ka më pas 3 muaj për t'u prononcuar, pos në rast se jeni vendosur në qendër qëndrimi. Në këtë rast, gjykatësi do të prononcohet brenda 72 orëve.**

✎ **Masa tjetër e dëbimit mund të merret kundër jush, vendimi i prefekturës për eskortim deri në kufi (APRF) mund të kundërshtohet në afat 48 orësh para Gjykatës administrative. Vendimi i Gjykatës ndërhyr në këtë rast brenda 72 orëve.**

## 4— Ndihamat sociale për kërkuesit e azilit

Ndihamat sociale i përkasin të drejtës për strehim, ndihma financiare dhe e drejta për shërim. Këto ndihma, të financuara nga Shteti, janë të ndryshme në bazë të situatës administrative të personit. Për të gëzuar të drejtën e ndihmës së përkohshme të pritjes (ATA), dhe sigurimit universal shëndetësor (CMU) apo për të hapur llogari bankare do të duhet të jepni dëshmi për vendbanim privat apo nëse nuk e keni **vendbanim te tjetri**. Në regjionin e Lionit, Forum refugies do të mund t'u strehojë me kusht edhe pas vlerësimit të gjendjes suaj.

### ● 4.1. Strehimi

#### 4.1.1. Strehimi në qendrën për pranim

Ekziston një dispozitiv i pritjes qendrat e të cilit janë shpërndarë në tërë territorin francez. Mund t'i qaseni enkas nëse jeni person që ka kërkuar azil dhe që ka një titull qëndrimi të lëshuar për këtë shkak.

Për të avancuar kërkesën tuaj për azil do të mund të strehoheshit në dy tipa të qendrave të tilla:

- qendrat për tranzit: ka 2 në Francë (Lion dhe Kretej).
- Janë të dedikuara për personat që kanë parashtruar kërkesën për mbrojtje. Kohëzgjatja e qëndrimit është e kufizuar në disa javë duke pritur më pas orientimin e CADA apo në tërë territorin kombëtarë.
- CADA-t (Qendrat për pritje të kërkueseve të azilit): për ta gëzuar këtë të drejtë, duhet të keni APS me vleftë 1 mujore apo një récépissé për 3 muaj. Strehimi propozohet gjatë tërë kohëzgjatjes së procedurës suaj. Nëse kërkesa juaj për azil refuzohet nga ana e Gjykatës kombëtare për të drejtën e azilit, duhet ta lëshoni qendrën për afat një mujor.

➤ **Që nga çasti i vizitës suaj të parë në prefekturë ju bëhet oferta për strehim. Nëse e refuzoni këtë ofertë, nuk do të mund më të keni të drejtë të përdorni ndihmën e përkohshme për pritje (ATA).**

Në përgjithësi, kërkesa juaj për strehim bëhet nga platforma për pranim për kërkues të azilit apo OFII dhe pranimit juaj validohet nga prefekti pas konsultimeve.

Një Komision prononcohet më pas për pranimet në qendra në funksion të vendeve të disponueshme në tërë territorin francez.

► **Duhet ditur që nëse ju propozohet një strehim, nuk do të thotë se ky strehim gjendet në rrethin ku ju e keni bërë kërkesën e azilit.**

► **Nëse e refuzoni këtë ofertë, nuk do të keni tjetër dhe e humbni të drejtën për ATA.**

Nëse jeni të strehuar në ndonjë qendër të CADA-ës, ju do të keni një përcjellje administrative (ndihmë për kërkesën e azilit), një përcjellje sociale (shëndeti, shkollimi i fëmijëve) dhe një ndihmë mujore për mbijetesë. Strehimi në qendër nuk ju mundëson të keni edhe ndihmën e pritjes të përkohshme. Ky dispozitiv është i financuar nga Shteti Francezë dhe e administruar nga shoqatat.

#### **4.1.2 Strehimi urgjent**

Ju keni mundësi të strehoheni në qendrat e pritjes urgjente. Këto qendra pranojnë vetëm për natën dhe nuk servojnë ushqim. Kohëzgjatja e qëndrimit në këto qendra nuk është e njëjtë në të gjitha qendrat dhe qëndrimi në to nuk mundet ti tejkalojë më shumë se disa ditë.

Është një numër i telefonit falas, **115**, që ju mund ta thirrni çdo ditë prej çdo kabine telefonike. Nëse e tregoni emrin dhe vendin ku gjendeni, ju mundeni të merreni përsipër nga njëra prej qendrave të strehimit urgjentë. Kjo varet nga vendet e lira. Ky numër është shumë shpesh i zënë. Por duhet provuar disa herë deri sa dikush t'ju lajmërohet.

#### **4.1.3 Strehimet tjera**

Ekzistojnë dhe forma tjera strehimi që janë të ndryshme sipas departamentit në të cilin gjendeni dhe nuk janë të përshkruar në këtë librezë.

### **● 4.2. Ndihma e pritjes të përkohshme**

Si kërkues i azilit, **ju nuk keni të drejtë të punoni**. Megjithatë, nëse u është lejuar përkohësisht qëndrimi dhe nëse OFPRA nuk ka marrë vendim brenda një viti prej datës kur ju e keni bërë kërkesën për azil ose jeni në procedurë lutjeje pranë CNDA-së mund të kërkonti qasje në tregun e punës. Mund të parashtroni kërkesë për leje pune në prefekturë, por kjo e fundit ka të drejtë tu refuzojë duke u bazuar në gjendjen e punësimeve në regjin apo në sektorin në fjalë. Kjo do të thotë se ju nuk do të mundeni të zini vendin e punës për atë punë që kualifikimi i përket me atë të një kërkuesi pune të shkruar në listat e kërkuesve të punës në rrethin ku ju banoni.

Kërkuesit e azilit që nuk janë të strehuar në qendër tranziti apo në një CADA, kanë të drejtë të marrin ndihmë financiare, ndihmën e pritjes së përkohshme, me kusht që të mos e kenë refuzuar propozimin për strehim në qendër apo kur kjo ofertë nuk është në dispozicion.

Për të pasur të drejtë në ndihmën e pritjes të përkohshme (ATA), duhet bërë kërkesa pranë zyrës për punësim. Do të duhet ti prezantoni edhe dokumentet vijues:

- një kopje të Lejes së përkohshme për qëndrim (APS) apo récépissé për 3 muaj;
  - kopjen e letrës që kërkesa juaj e azilit është regjistruar në OFPRA,
  - një vërtetim që nuk keni të ardhura tjera apo që nuk keni strehim me titullin e ndihmës sociale të Shtetit;
  - një vërtetim të vendbanimit tuaj;
  - një certifikatë bankare.
- Kërkuesit e azilit që nuk u është lejuar qëndrimi dhe që janë vendosur nën procedurë prioritare meqë janë nga shtete amë të sigurta do të mund të gëzojnë të drejtën e ATA-së gjatë kohëzgjatjes së procedurës së OFPRA. Ata duhet të prezantojnë në zyrën për punësim të njëjtat dokumente si dhe kërkuesit tjerë të azilit por duke e zëvendësuar kopjen e lejes së qëndrimit me kopjen e vendimit të vendosjes në procedurë prioritare.

**Shuma ditore për ndihmë të pritjes së përkohshme është fikse dhe për vitin 2009 është 10,54 euro në ditë (gjgj 316,23 euro në muaj që ka 30 ditë).** Kjo ndihmë i jepet çdo të rrituri gjatë tërë kohëzgjatjes së procedurës të kërkesës për azil. Nga ana tjetër, nëse kërkesa juaj refuzohet nga OFPRA (pa parashtruar lutje) ose nga CNDA, këto deponime përfundojnë.

Duhet ditur edhe se pas 6 muajsh të deponimeve, duhet t'i tregoni zyrës për punësim gjendjen e resurseve tuaja që të vazhdojnë deponimet. Në të kundërtën, do të ndërpriten.

**► NB: Nëse OFPRA ose CNDA ju kanë njohur statusin refugjat, karta e banuesit ju jep të drejtën e punës dhe ju gëzoni të njëjtat të drejta si dhe shtetasit francez, pos të drejtave qytetare. Në të njëjtën mënyrë, karta e qëndrimit të përkohshëm e marrë në emër të mbrojtjes së dorë së dytë ka vlerën e lejes së punës.**

### ● 4.3. Sigurimi universal mjekësor (CMU)

Si kërkues i azilit dhe në bazë të ardhurave tuaja, **ju keni të drejtë për Sigurim universal mjekësor**. Kjo mundësi ju jepet posa të kërkoni azilin dhe me paraqitjen **e thirrjes për në prefekturë, të APS apo të récépissé të shoqëruar me një vërtetim të vendbanimit**. CMU përbëhet nga dy të drejta : një mbulesë bazë dhe një mbulesë plotësuese që ju mundëson marrjen sipër të të gjithave shpenzimeve mjekësore për ju, bashkëshorten dhe fëmijët e juaj të mitur. Në mungesë të dokumenteve të gjendjes civile ku përcaktohet kompozimi i familjes tuaj, duhet mbushur një deklaratë nderi. Duhet bërë të njëjtën gjë sikur të mos keni fare dokument që vërteton se nuk keni të ardhura.

Për të pasur të drejtë për CMU, duhet **bërë kërkesën pranë shërbimit të Kasës kombëtare për sigurim shëndetësor (CPAM) të vendit ku ju banoni** ose pranë disa shoqatave. Mbasi të regjistrohet kërkesa juaj, ju do të keni një vërtetim të marrjes përsipër dhe do të keni një vërtetim për 1 vit me CMU complémentaire (plotësuese) dhe një numër të përkohshëm të sigurimit. Ju nuk duhet të harroni ta vazhdoni CMU complémentaire dy muaj para se ti del afati. Kur të merrni statusin e refugjatit apo mbrojtjen e dorës së dytë, ju do të keni një numër të përhershëm dhe një «carte vitale».

► ***Të drejtat për CMU bazë fillojnë posa të bëni kërkesën tuaj, kurse CMU complémentaire (mutuelle) fillon prej ditës së parë të muajit kur ju e keni bërë kërkesën. Për shembull, nëse ju e bëni kërkesën më 15 shtator, të drejtat për CMU bazë fillojnë me 15 shtator kurse CMU complémentaire fillon me 1 tetor.***

► ***Në pritje të CMU, ju mundeni të shkoni në qendrat spitalore ku ka shërbime emergjente shëndetësore (PASS). Aty, mund të kontrolloheni nga mjeku dhe të merrni barëra falas.***

► ***Në anën tjetër, disa shoqata propozojnë të drejtën për vizitë dentisti, oftalmologu, psikologu edhe pse nuk jeni të siguar. PMI (Mbrojtja e nënës dhe fëmijut) mund të kujdesen për fëmijët e vegjël. Qendrat për edukim dhe planifikim familjar sugjerojnë shërbime emergjente për gra.***

► ***Nëse jeni të sëmurë prej shumë kohe, ju mundeni të gëzoni marrjen përsipër për të gjitha shërimet në lidhje me këtë sëmundje.***

## ● 4.4 Ndhimja mjekësore e shtetit (AME)

Nëse kërkesa juaj shqyrtohet në procedurën prioritare, mund të keni të drejtë në ndihmën mjekësore të shtetit me kusht që ju të jeni prezent në Francë që 3 muaj. Ju mundeni pra të shëroheshi në spitale, tek mjekët e qytetit dhe ti merrni barnat në barnatore.

Duhet të bëni kërkesën pranë shërbimeve të sigurimit social të vendit ku ju qëndroni apo në shërbimet PASS të spitaleve.

## ● 4.5 Të drejtat sociale të fëmijëve

### 4.5.1. Ndhimat financiare në bazë fëmijës dhe familjes

Nëse nuk keni strehim në bazë të ndihmës sociale të Shtetit dhe nëse nuk keni të ardhura të mjaftueshme, Këshilli i Rrethit ku ju banoni ose shërbimet sociale të komunës tuaj mundën t'ju ndihmojnë me ndihma financiare të cilat janë të ndryshme nga vendi se ku gjendeni.

### 4.5.2. Përkujdesi shëndetësor

Fëmijët tuaj të vegjël mund të përcillen në mënyrë mjekësore nga personeli mjekësor i PMI (Protection Maternelle et Infantile). Kjo vlen edhe për fëmijët e porsalindur dhe për vaksinat.

### 4.5.3. Shkollimi

Fëmijët mundën të shkollohen prej moshës 3 vjeçare në kopshtet e fëmijëve, por kopshti nuk ka detyrim të pranojë fëmijën tuaj.

Nga ana tjetër, shkollimi në Francë është i detyrueshëm prej moshës 6 vjeçare deri në moshën 16 vjeçare.

Për të regjistruar fëmijën tuaj në parashkollore, duhet paraqitur një dokument që e vërteton që është fëmija juaj (certifikatë e lindjes nga shteti amë). Nëse nuk keni dokument nga vendi juaj, mund të paraqisni dokument të dhënë nga administrata franceze (për shembull vërtetimin e CMU). Duhet po ashtu të vërtetoni se keni adresë dhe me vërtetë që fëmija juaj është i vaksinuar rregullisht.

Regjistrimi bëhet në Komunën e vendit ku gjendeni. Disa shkolla kanë klasa speciale për fëmijët e posa arritur, të dedikuara fëmijëve të sapo arritur jo frankofonë. Një vlerësim bëhet në fillim për të orientuar më mirë fëmijën tuaj.

Për të regjistruar fëmijën tuaj në shkollën fillore dhe të mesme, duhet ta regjistroni në shkollën e lagjes ku banoni. Pas vlerësimit të nivelit të fëmijut tuaj, përgjegjësi i shkollës do ta caktojë klasën e fëmijut tuaj ose në shkollën e vetë ose në ndonjë shkollë tjetër, nëse fëmiju juaj orientohet për ndonjë klasë të specializuar.

# 5— Të drejtat e personave të mbrojtur

Nëse u është njohur statusi i refugjatit apo u është dhënë mbrojtja e dorës së dytë, keni të drejtë të kërkonti të drejta dhe shërbime të caktuara.

## ● 5.1. Mbrojtja në Francë

Ju jeni tashmë të vendosur nën mbrojtjen e autoriteteve franceze. OFPRA është ajo që ju lëshon aktet e gjendjes civile që nuk mund t'i merrni më nga autoritetet e shtetit amë.

👉 **Nëse rivendosni kontakt me autoritetet diplomatike apo konsullore të shtetit amë, OFPRA mund t'ua tërheq mbrojtjen.**

Në rast se është dhënë mbrojtje e dorës së dytë, OFPRA i lëshon aktet e gjendjes suaj civile pos kur vlerëson se mund t'u drejtoheni autoriteteve konsullore të shtetit amë.

## ● 5.2. Qëndrimi në Francë

■ **Si refugjat**, ju keni të drejtën e një karte të banuesit 10 vjeçare, të ripërtishme dhe më të gjitha të drejtat. Kjo kartë ju lejon të lëvizni lirshëm në Francë.

Që nga pranimi i vendimit të OFPRA-së apo të CNDA që ju njeh statusin refugjat, ju duhet t'i drejtoheni prefekturës që ju lëshon récépissé të parë 3 mujore të përrirëshme me shënimin “i njohur si refugjat”. Më pas me prezantimin e dokumenteve të gjendjes civile të përgatitura dhe dërguara nga OFPRA, prefektura ju jep titullin e parë të qëndrimit. Ky récépissé, me vlefshmëri 3 muaj, do të ripërtrihet deri në dhënien përfundimtare të kartës suaj të banuesit.

■ **Si gëzues i mbrojtjes së dorës së dytë**, ju keni të drejtë në një **kartë të përkohshme qëndrimi me shënimin “jetë private dhe familjare”**, që përtrihet nëse kushtet janë akoma të pëmbushura. Kjo kartë ju lejon të qarkulloni në territorin francez.

Që nga pranimi i letrës që ju njeh mbrojtjen, duhet t'i drejtoheni

prefekturës që ju lëshon një **récépissé të parë** për 3 muaj me mundësi ripërtrirjeje deri në dhënien përfundimtare të kartës për banim. Para përfundimit të kartës suaj të përkohshme për qëndrim, duhet të kërkonti vazhdimin e saj. Prefektura me këtë rast do të drejtohet në OFPRA që mund të refuzojë përtrirjen e mbrojtjes suaj nëse shkaqet që kanë justifikuar dhënien e saj nuk ekzistojnë më.

➤ **Prefektura mund të refuzojë t'u japë titull qëndrimi nëse prezenca juaj në Francë paraqet një kërcënim për rendin publik. Në disa kushte, prefektura mund t'u konfiskojë titullin tuaj të qëndrimit.**

### ● **5.3. Integrimi në Francë**

Pas përfundimit të një interviste në Zyrën franceze për imigrim dhe integrim (OFII), do të nënshkruani kontratë për pritje dhe integrim (CAI) të themeluar nga OFII dhe të nënshkruar nga prefekti që ju ka lëshuar titullin e qëndrimit.

Në kuadër të kontratës, ju angazhoheni që të ndiqni falas trajnimet e parapara me kontratë (trajnim qytetar dhe lingustik) dhe të kaloni kontrollin e detyrueshëm mjekësor.

### ● **5.4. Udhëtime jashtë vendit**

■ **Nëse jeni refugjat** dhe dëshironi të udhëtoni jashtë Francës, një dokument udhëtimi me vlefshmëri 2 vjet ju lëshohet në bazë të kërkesës suaj nga prefektura.

■ **Nëse e gëzoni të drejtën e mbrojtjes së dorës së dytë** dhe OFPRA vlerëson se nuk mund më t'u drejtoheni autoriteteve të shtetit amë, mundeni gjithashtu të merrni në prefekturë edhe **një titull udhëtimi me vlefshmëri 1 vjet.**

➤ **Këto dokumente udhëtimi nuk ju lejojnë të ktheheni në shtetin amë. Nuk duhet në asnjë rast t'u drejtoheni autoriteteve apo shërbimeve konsullore të shtetit amë.**

Nga ana tjetër, nëse OFPRA nuk vlerëson të nevojshme të prodhojë akte të gjendjes civile që ju mund t'i siguronin nga autoritetet e shtetit amë, e mbani pasaportën tuaj origjinale dhe mund të udhëtoni lirshëm me të. Karta juaj e banuesit do t'u mundësojë të hyni sërish në territorin francez. Për sa i përket hyrjes në territorin e shteteve të treta, duhet t'i respektoni detyrimet ligjore që i vendos ai shtet.

## ● 5.5. Qëndrim dhe mbrojtje e familjes së ngushtë

■ **Nëse jeni refugjat**, bashkëshorti juaj (nëse martesa i paraprin marrjes së statusit të refugjatit, ose nëse është bërë para të paktën një vjet dhe akoma jeni në bashkësi) dhe fëmijët tuaj të mitur kur arrijnë moshën 18 vjeçare ( apo 16 vjeçare nëse dëshirojnë të punojnë) mund të kërkojnë me të drejta të plota një kartë banuesi 10 vjeçare.

Bashkëshorti dhe fëmijët tuaj duhet t'i drejtohen prefekturës së vendbanimit tuaj.

Këto të fundit gjithashtu mund të fitojnë mbrojtjen e autoriteteve franceze pranë OFPRA-së në bazë të bashkimit familjar.

■ **Nëse e gëzoni të drejtën e mbrojtjes së dorës së dytë**, bashkëshorti juaj (nëse martesa i paraprin marrjes së statusit të refugjatit, ose nëse është bërë para të paktën një vjet dhe akoma jeni në bashkësi) dhe fëmijët tuaj të mitur kur arrijnë moshën 18 vjeçare ( apo 16 vjeçare nëse dëshirojnë të punojnë) mund të kërkojnë me të drejta të plota një kartë të përkohshme qëndrimi 1 vjeçare. Bashkëshorti dhe fëmijët tuaj duhet t'i drejtohen prefekturës së vendbanimit tuaj.

■ **Nga ana tjetër**, nëse familja juaj është akoma në shtetin amë në çastin e njohjes së statusit tuaj si refugjat apo mbrojtjes së dorës së dytë, mund t'i merrni ata në Francë përmes procedurës së bashkimit familjar duke iu drejtuar Nëndrejtorisë për qarkullim të të huajve në OFII.

Nëse e keni themeluar familjen tuaj pas njohjes së statusit tuaj si refugjat apo mbrojtjes së dorës së dytë, në kuadër të bashkimit familjar mund t'iu bashkëngjitet në Francë familja juaj. Pranimi i bashkimit familjar supozon se do të përgjigjeni disa kushteve për stazh (18 muaj), të ardhura apo vendbanim. Për të filluar procedurën, duhet të keni dosje të kompletuar pranë Delegacionit të OFII të departamentit tuaj.

## ● 5.6. Qasje deri te tregu i punës

■ **Nëse jeni refugjat**, keni të drejtë qasjeje të lirë në tregun e punës që nga marrja e récépissé të parë që mban shënimin “njihet si refugjat”.

■ **Nëse e gëzoni të drejtën e mbrojtjes së dorës së dytë** keni të drejtë të punoni që nga marrja e récépissé të parë që mban shënimin “ka kërkuar lëshimin e titullit të parë të qëndrimit”.

Keni të drejtë të kërkonit Kontratë pune me kohë të caktuar (CDD) apo të pacaktuar (CDI).

Mund të shënoheni në listën e kërkueseve të punës, të gëzoni të drejtën e një shoqërimi të personalizuar, bile edhe të vazhdoni studimet.

➤ **Disa profesione janë të nënshtruara disa kushteve të diplomave apo shtetësisë.**

**Një kartë banuesi e dhënë në një departament tejoqeanik nuk e lejon mbajtësin të punojë në metropol.**

## ● 5.7. Qasje në vendbanim

Nëse keni qenë i strehuar në Qendër pritjeje për kërkues azili (CADA) gjatë procedurës për azil, atëherë mundeni pas marrjes së mbrojtjes suaj, të qëndroni në qendër për 3 muaj me të drejtë ripërtrirje pasi të keni marrë pëlqimin e prefektit.

Si person i mbrojtur, mund të kërkonti nga OFII të gëzoni të drejtën e një vendi në Qendër të përkohshme për strehim (CPH).

Pos kësaj, mund të kërkonti qasje në vendbanim privat apo social duke dorëzuar dosjen pranë institucioneve apo organizatave kompetente.

## ● 5.8. Shëndeti

Nëse ju pranohet e drejta e qëndrimit gjatë procedurës për azil, anëtarësimi juaj në sigurimin universal shëndetësor (CMU) bazë vazhdon.

Nëse nuk u është pranuar qëndrimi gjatë procedurës për azil, duhet të ndërmerri hapa për të gëzuar të drejtën e CMU pranë Kasës kombëtare për sigurim shëndetësor (CPAM) të vendbanimit tuaj. Do të duhet të njoftohet çdo ndryshim i situatës administrative CPAM-it të vendbanimit tuaj. Në të njëjtën mënyrë, duhet njoftuar të gjitha ushtrimet e detyrave të paguara apo anëtarësimet në regjime rrogash.

## ● 5.9. Shërbime sociale dhe familjare

Si gëzues i një mbrojtjeje, keni të drejtën e ndihmave të ndryshme financiare duke iu drejtuar Kasës për ndihma familjare (CAF) apo organizmave tjerë udhëzues në vendbanimin tuaj.

Nëse i plotësoni kushtet e kërkuara, keni të drejtë në të ardhura të solidaritetit aktiv (RSA), ndihma familjare, ndihmë për vendbanim apo ndihmë për të rritur të hendikepuar.

## ● 5.10. Natyralizimi

■ **Nëse jeni refugjat,** keni të drejtë të kërkonti të fitoni kombësinë franceze me dekret që nga njohja e statusit refugjat.

■ **Nëse e gëzoni të drejtën e mbrojtjes së dorës së dytë** duhet të vërtetoni 5 vjet qëndrim të pandërprerë në Francë para se të kërkonti natyralizimin.

■ Në kuadër të kësaj kërkesë, duhet vërtetuar se asimilimin tuaj me bashkësinë franceze (njohja e gjuhës frënge) dhe morali juaj.

■ Vendi për parashtrimin e kërkesës për natyralizim është prefektura e vendbanimit tuaj.

## 6— Rishqyrtimi në OFPRA

Pas mospranimit të kërkesës tuaj nga CNDA, keni të drejtë po ashtu të kërkonte nga OFPRA shqyrtimin e sërishëm të kërkesës tuaj por **vetëm** nëse ju keni **elemente të reja**, domethënë element:

- pas datës së refuzimit nga CNDA apo para datës por për të cilin keni marrë dijëni më pas;
- i një natyre që justifikon brengat tuaja të persekutimit në rast kthimi në shtetin amë.

Mund të merrni këshillë pranë një shoqate apo avokati.

Duhet më së pari të paraqiteni në prefekturë dhe të kërkonte një APS (autorizim të përkohshëm për qëndrim). Prefektura do të shqyrtojë kërkesën tuaj për APS sikur të ishte hera e parë që e bëni këtë kërkesë.

■ **Prefektura ju pajis me APS për 15 ditë:** prej momentit që u pajiseni me APS dhe me dosjen e rishqyrtimit nga OFPRA, **keni 8 ditë** për të dërguar kërkesën tuaj në OFPRA e cila mbasi do ta regjistrojë kërkesën tuaj. OFPRA do t'u njoftojë për vendimin e saj me letër të rekomanduar me vërtetim pranimi.

■ **Prefektura refuzon t'ju pajis me APS** dhe ju vë në procedurë prioritare meqë vlerëson se jeni nga një shtet që i sigurt, ose për shkak se prezenca juaj paraqet kërcënim për rendin publik apo se kërkesa juaj është mashtroese apo e tepërt .

Prefektura ju dorëzon në të dy rastet formular të rishqyrtimit që ju e plotësoni dhe më pas duhet të vini sërish në prefekturë brenda 15 ditëve me dosje të kompletuar në zarf të mbyllur. Prefektura nuk duhet të dijë elementet e kërkesës suaj për rishqyrtim që janë të besueshme. Me pranimin e dosjes të rishqyrtimit, prefektura ia dorëzon OFPRA-së duke cekur që ka karakter prioritar.

OFPRA do të njoftojë për vendimin e saj përmes një letre të rekomanduar me vërtetim pranimi në afat prej 15 ditësh.

Në rast se OFPRA hedhë poshtë kërkesën tuaj, ju keni të drejtë të bëni lutje pranë CNDA në afat prej 1 muaji. Në rast të vendosjes në procedurë prioritare, kjo lutje nuk është pezulluese dhe ju mund të dërgoheni në vendin tuaj para se CNDA të merr vendim.

## 7— Adresat e nevojshme

### ● 7.1. Rrethi i Parisit

(kjo listë nuk është e plotë)

#### ■ OFPRA

Zyra Franceze për Mbrojtje të Refugjatëve dhe Personave pa Kombësi Ligjore (Office français de protection des réfugiés et apatrides)  
201, rue Carnot / 94136 FONTENAY SOUS BOIS Cedex  
tel : 01 58 68 10 10  
faks : 01 58 68 18 99

#### ■ CNDA

Gjykata Kombëtare për të Drejtën e Azilit (Cour nationale du droit d'asile)  
35, rue Cuvier / 93558 MONTREUIL SOUS BOIS Cedex  
tel : 01 48 18 40 00  
faks : 01 48 18 41 97

#### ■ HCR

Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (Haut Commissariat des Nations unies pour les réfugiés)  
9, rue Kepler / 75116 PARIS  
tel : 01 44 43 48 58  
faks : 01 40 70 07 39

#### ■ OFII

Zyra Franceze për Imigrim dhe Integrim (Office français de l'immigration et de l'intégration)  
44, rue Bague / 75015 PARIS  
tel : 01 53 69 53 70  
faks : 01 53 69 53 69

#### ■ ACAT

Shoqata Krishtere për Abolicion të Torturës (Association des chrétiens pour l'abolition de la torture)  
7, rue Georges Lardennois / 75019 PARIS  
tel : 01 40 40 42 43  
faks : 01 40 40 42 44

■ **Act up**

45, rue Sedaine / 75011 PARIS  
tel : 01 48 06 13 89  
faks : 01 48 06 16 74

■ **Amnesty international, Njësia Franceze**

76, boulevard de la Villette / 75019 PARIS  
tel : 01 53 38 65 16  
faks : 01 53 38 55 00

■ **Shoqata Primo Lévi**

107, avenue Parmentier / 75011 PARIS  
tel : 01 43 14 08 50  
faks : 01 43 14 08 28

■ **APSR**

Shoqata për Pritjen e Mjekëve dhe Personelit Shëndetësor Refugjat në Francë (Association d'accueil aux médecins et personnels de santé réfugiés en France)  
Hôpital Sainte Anne  
1, rue Cabanis / 75014 PARIS  
tel : 01 45 65 87 50  
faks : 01 53 80 28 19

■ **CAEIR**

Komiteti për Ndihmë të Jashtëzakonshme për Refugjatët Intelektualë (Comité d'aide exceptionnelle aux intellectuels réfugiés)  
43, rue Cambronne / 75015 PARIS  
tel : 01 43 06 93 02  
faks : 01 43 06 57 04

■ **CASP**

Qendra e Aksionit Social Protestant (Centre d'action sociale protestant)  
20, rue Santerre / 75012 PARIS  
tel : 01 53 33 87 50  
faks : 01 43 44 95 33

■ **CIMADE**

Shërbimi Ekumenik i Ndihmës së Ndërsjellë (Service œcuménique d'entraide)  
64, rue Clisson / 75013 PARIS

tel : 01 44 18 60 50  
faks : 01 45 56 08 59

■ **COMEDE**

Komiteti Mjekësor për të Ikurit – Spitali në Bisetr (Comité médical pour les exilés - Hôpital de Bicêtre)  
78, rue du Général Leclerc BP 31 / 94272 LE KREMLIN BICETRE  
tel : 01 45 21 38 40  
faks : 01 45 21 38 41

■ **Kryqi i Kuq Francez (Croix Rouge Française)**

1, place Henry Dunant / 75008 PARIS  
tel : 01 44 43 11 00  
faks : 01 44 43 11 69

■ **FASTI**

Federata e Shoqatave për Përkrahje të Punëtorëve Imigrantë  
(Fédération des associations de soutien aux travailleurs immigrés)  
58, rue des Amandiers / 75020 PARIS  
tel : 01 58 53 58 53  
faks : 01 58 53 58 43

■ **FTDA**

France terre d'asile  
25, rue Ganneron / 75018 PARIS  
tel : 01 53 04 39 99  
faks : 01 53 04 02 40

■ **GAS**

Grupi për Pritje Solidare (Groupe accueil solidarité)  
17, place Maurice Thorez / 94800 VILLEJUIF  
tel : 01 42 11 07 95  
faks : 01 42 11 09 91

■ **GISTI**

Grupi për Informim dhe Përkrahje të Imigrantëve (Groupe d'information et de soutien des immigrés)  
3, villa Marcès / 75011 PARIS  
tel : 01 43 14 60 66  
faks : 01 43 14 60 69

■ **LDH**

Lidhja e të Drejtave të Njeriut (Ligue des droits de l'Homme)

138, rue Marcadet / 75018 PARIS

tel : 01 56 55 51 00

faks : 01 56 55 51 21

■ **MRAP**

Lëvizja Kundër Racizmit dhe për Miqësi në mes Popujve (Mouvement contre de racisme et pour l'amitié entre les peuples)

43, boulevard Magenta / 75010 PARIS

tel : 01 53 38 99 99

faks : 01 40 40 90 98

■ **Secours Catholique**

23, boulevard de la Commanderie / 75019 PARIS

tel : 01 48 39 10 92

faks : 01 48 33 79 70

■ **SNPM**

Shërbimi kombëtar pastoral i imigrantëve (Service national de la pastorale des migrants)

269 bis, rue du Faubourg St Antoine / 75011 PARIS

tel : 01 43 72 47 21

faks : 01 46 59 04 89

■ **Sous-direction de la circulation des étrangers  
(Nëndrejtoria e Qarkullimit të të Huajve)**

11 rue de la Maison blanche / BP103

44036 Nantes cedex 01

tel : 08 26 08 06 04

## ● 7.2. Rrethi i Lyon-it

Për departamentet tjera, listën e keni në dispozicion në prefekturën tuaj.

### ■ Préfecture du Rhône (Prefektura e Ronës )

Service des étrangers (Shërbimi për të huaj)

14, quai Général Sarrail / 69006 Lyon

tel : 04 72 61 67 06

Tramvaji T1 – stacioni Saxe-Préfecture

### ■ Préfecture du Rhône - Service asile (Prefektura e Ronës – Shërbimi për Azil)

12, rue des Cuirassiers / 69003 Lyon

tel : 04 72 61 68 59 ose 04 72 61 68 65

Metro linja B – stacioni Part-Dieu

Apo tramvaji T1- stacioni Part-Dieu Servient

## — Platforma e pritjes për kërkuesit e azilit

(ndihmë administrative, sociale dhe juridike)

### ■ Forum réfugiés – Service d'accueil et d'orientation (Shërbimi i Pritjes dhe Orientimit)

(gjetje vendbanimi, strehim, ndihmë për kërkesën e azilit, ndihma shëndetësore dhe sociale, CMU, AME ...)

326, rue Garibaldi / 69007 Lyon

tel : 04 72 77 68 02

Metro linja D – stacioni Garibaldi

### ■ Entretemps - Le Mail

(strehim urgjent)

Qendër për Këmbim në Perrache)

tel : 04 78 42 24 28

Metro linja A- stacioni Perrache)

### ■ Secours Catholique

(ndihmë për kërkesë azili pranë OFPRA dhe CNDA)

12, rue Montbrillant / 69003 Lyon

tel : 04 72 33 38 38

Metro linja D – stacioni Monplaisir Lumière

## — Ndhimë juridike dhe administrative

### ■ CIMADE (këshilla Juridike dhe Falas për të Drejtën e të Huajve)

të martën (14h-16h30) / të mërkurën (9h-12h) / të premten (9h-12h)  
33, rue Imbert Colomès / 69001 Lyon  
tel : 04 78 28 47 89 (për informata dhe caktim takimi)  
Metro linja C – stacioni Croix Paquet

### ■ Croix Rouge française – Service réfugiés (Shërbimi për Refugjatë)

Të hënën (14h30-17h) / të martën (9h15-11h30) / të premten (9h15-11h30)  
61, rue de Créqui / 69006 Lyon  
tel : 04 72 43 59 09  
Metro linja A – stacioni Foch

## — Veprime administrative

### ■ Office français de l'immigration et de l'intégration (OFII)

7, rue Quivogne / 69002 Lyon  
tel : 04 72 77 15 40  
Metro linja A –stacioni Perrache

### ■ Pôle Emploi (në varësi të vendbanit tuaj)

Pika e Lionit Jug (Site de Lyon Sud) (për persona me vendbanim në lagjën 7 dhe 8)  
63, rue Bollier / 69007 LYON  
tel : 39 49

## — Ndhimë të ndryshme

(pritje ditore, ndihmë urgjente, ndihmë në ushqim, veshje, bileta autobusi...)

### ■ Antenne solidarité Lyon 7e

40, rue Bancel / 69007 Lyon  
tel : 04 72 76 32 50  
Metro linja B – Stacioni Jean Macé

### ■ Antenne Solidarité Lyon 2e

16, rue Franklin / 69002 Lyon  
tel : 04 78 42 03 52  
Metro linja A – Stacioni Ampère Victor Hugo

### ■ **Croix Rouge française**

(për familje, për familje me një prindër, gra shtatzëna, çiftë. Që kanë dhënë kërkesën për azil apo kërkesën për zyrtarizim të dokumenteve shëndetësore. Ndihmë në ushqim, veshje, kurse të frëngjishtes, ndihmë për foshnje, biletë TCL..)

Të hënën (14h30-17h) / të martën (9h15-11h30) / të premten (9h15-11h30)

61, rue de Créqui / 69006 Lyon

tel : 04 72 43 59 09

Metro linja A – Stacioni Foch)

### ■ **Entraide Protestante**

(ndihmë në ushqim, në veshje, bileta TCL)

Të hënën (14h-17h00) / të enjten (9h-12h)

336, rue André Philip / 69007 Lyon

tel : 04 72 71 00 31

Metro linja D – stacioni Garibaldi

### ■ **Péniche Accueil « Le Balajo » (Anija për Pritje “Le Balajo”)**

(pritje ditore, dush, parukeri, përkujdesje mjekësore)

Nga e hëna deri të premten nga ora 14h deri më 17h30

Përballë 37, quai Gailleton / 69002 Lyon)

tel : 04 72 41 72 45

Metro linja A – stacioni Ampère Victor Hugo)

### ■ **Relais SOS (për meshkuj që janë vetëm dhe kanë më shumë se 25 vjet)**

(pritje ditore, ushqim dhe larje robash)

Nga e hëna deri të premten nga ora 7h deri më 16h30

90, rue Marius Berliet / 69008 Lyon

tel : 04 78 76 35 48

Autobusi 23 – stacioni Agnan / Tramvaji T2 – stacioni Villon

### ■ **Restaurants du cœur**

(ndihmë në ushqim, përkujdesje për foshnje)

20-22, Rue St Michel / 69007 Lyon

tel : 04 78 58 97 29

### ■ **Secours Populaire (ndihmë në ushqim)**

Caktoni takim përmes telefonit të hënën pasdite apo të mërkurën në mëngjes

6, rue Gaspard André / 69002 Lyon

tel : 04 72 77 87 77

Metro linja A – stacioni Bellecour

### — **Strehim urgjent**

Në **115**, me telefon nga cila do kabinë telefonike

### **Vetëm gra**

#### ■ **Armée du Salut**

131, avenue Thiers / 69006 Lyon

tel : 04 78 52 60 80

Metro linjat A dhe B – stacioni Charpennes

Tramvaji T1 – stacioni Charpennes

#### ■ **Point Nuit**

69, rue de Cuire / 69004 Lyon

tel : 04 78 29 87 45

Metro linja C – stacioni Hénon

### **Vetëm burra**

#### ■ **Foyer Notre Dame des Sans Abri**

3, rue du Père Chevrier / 69007 Lyon

tel : 04 72 76 73 53

85, rue Sébastien Gryphe / 69007 Lyon

tel : 04 37 37 49 68

Metro linja D – stacioni Guillotière

### — **Banjë dhe dushi komunal**

(sipas udhëzimeve të antenave për solidaritet)

4, impasse Flesselles / 69001 Lyon

tel : 04 78 28 28 03

13, rue Benjamin Delessert / 69007 Lyon

tel : 04 78 72 69 01

## — Shëndeti

### ■ Caisse primaire d'assurance maladie (CPAM)

(na varësi të vendbanimit tuaj)  
Nisma e marjes së të drejtës për CMU  
69907 Lyon Cedex 20

### ■ Dispensaire général de Lyon

10, rue de Sévigné / 69003 LYON  
tel : 04 78 14 14 14

### ■ France Humanitaire

(konsultime mjeku për dhëmbë dhe sy)  
22, quai Gailleton / 69002 Lyon  
tel : 04 78 37 17 42  
Metro linja A –stacioni Bellecour

### ■ Hôpital Edouard Herriot

5, place Arsonval / 69003 Lyon  
tel : 0820 0820 69  
Metro linja D – stacioni Grange Blanche

### ■ Hôtel Dieu

PASS - Permanence d'accès aux soins de santé (Kujdestaria për qasje në përkujdes shëndetësor)  
1, place de l'hôpital / 69002 Lyon  
tel : 04 72 41 33 66  
Metro linja A –stacioni Bellecour

### ■ Médecins du monde

13, rue Sainte Catherine / 69001 Lyon  
tel : 04 78 89 99 99 ou 04 78 29 59 14  
Metro linja A –stacioni Hôtel de Ville

## — Përkthime gojore dhe përkthime dokumentesh

### ■ Inter Service Migrants Corum (ISM)

32, cours Lafayette / 69003 Lyon  
tel : 04 72 84 78 99  
Atobusët 1-4-18-27-stacioni Saxe Lafayette

## — Kurse për gjuhën frenge

### ■ **Croix Rouge française – Service réfugiés (Shërbimi i refugjatëve)**

61, rue de Créqui / 69006 Lyon

tel : 04 72 43 59 09

Metro linja A –stacioni Foch

### ■ **Secours Catholique**

12, rue Montbrillant / 69003 Lyon

tel : 04 72 33 38 38

Metro linja D - stacioni Monplaisir Lumière

## 8 — Lista e shteteve amë të sigurt

Benini,  
Bosnjë Hercegovina,  
Gana,  
Gjeorgjia,  
India,  
Kap Verde,  
Kroacia,  
Madagaskari,  
Mali,  
Maqedonia,  
Mauritius,  
Monogolia,  
Senegali,  
Tanzania dhe  
Ukraina



Forum refugies është një shoqatë që punon që nga viti 1982 për të mbrojtur të drejtën e azilit dhe refugjatëve. Me mbi 90 të punësuar, Forum refugies u bë një aktor i njohur dhe privilegjuar në fushën e azilit dhe merr mbështetje nga partnerë publik dhe privat, kombëtarë dhe evropianë.

## Pranimi i refugjatëve —

**Pranojmë:** Forum refugies mbështet funksionimin e disa qendrave të azilkerkuesve dhe refugjatëve dhe ofron më shumë se 500 000 net pranimi në vit (duke përfshirë edhe hotelet). Për më tepër, shoqata është e angazhuar rregullisht në operacionet e strehimeve urgjente (Shqiptarëve në 1990, Romëve në 1995 dhe 1997, Kosovarëve në vitin 1999, Kurdëve në vitin 2001).

**Përgjigjemi nevojave administrative:** Nga platforma e tij për pritje të refugjatëve, Forum refugies ofron shërbimin postar pastrim, shqyrton kërkesat e strehimit dhe jep këshilla ligjore dhe administrative për mijëra njerëz që nuk gëzojnë strehim në qendër pranimi. Nxitja e integritit të refugjatëve:

Me ndihmën e Bashkimit Evropian, Forum refugies kujdeset dhe punon në partneritet me shërbimet e të drejtës së përgjithshme për të lehtësuar integrimin e refugjatëve me status të tillë duke i ndihmuar ata me gjetjen e strehimit, aftësimin të tyre, punësimin.

## Mbrojtje e të drejtës së azilit —

**Në Francë dhe Evropë:** Anëtar i Komitetit Evropian për Refugjatët dhe të ikurit (ECRE) dhe Koordinimi francez për të drejtën e Azilit (CFDA), Forum refugies është e angazhuar për të mbrojtur të drejtën e azilit dhe është duke luftuar çdo ditë për njohjen dhe përmirësimin e kushteve për ushtrimin e kësaj të drejte.

**Mobilizojmë dhe informojmë:** Në mënyrë që të mobilizojnë opinionin publik mbi situatën e refugjatëve, Forum refugies i informon rregullisht mediat dhe prodhon vegla të ndryshme të informative:

- revistë tremujore "Gazeta e Forum refugies "
- Faqe interneti e pasur dhe e dokumentuar: [www.forumrefugies.org](http://www.forumrefugies.org)
- Raport vjetor mbi azilin "Azili në Francë dhe Evropë - Gjendja në teren"
- Udhëzues për azil kërkues

Duke marrë pjesë në studime, me regjistrimin në rrjete hulumtuese, me veprime gjyqësore në gjykatat, duke ofruar seanca trajnuese për profesionistët, Forum refugies vë kompetencën e tij, përvojën dhe ekspertizën në shërbim të mbrojtjes së të drejtës së azilit.

**Forum refugies // Siège social**

28 rue de la Baisse - BP 71054

69612 VILLEURBANNE CEDEX

T + 33 (0)4 78 03 74 45 // F + 33 (0)4 78 03 28 74

Posta elektronike (E-mail) : [direction@forumrefugies.org](mailto:direction@forumrefugies.org)

Faqja e internetit : [www.forumrefugies.org](http://www.forumrefugies.org)